




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>01-4554/13</u>
Nr. ffaq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>31.12.2013</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	13/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Mehmet RAMA Menaxher i Prokurimit – Komuna e Drenasit
CC:	z. Nexhat DEMAKU Kryetar i Komunës së Drenasit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin: “Ndërtimi i kanalizimeve për ujëra të zeza në fshatin Tërsteniku II (Lagja Gjoka, Bazaj) dhe Poklek i Ri”



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: “Ndërtimi i kanalizimeve për ujëra të zeza në fshatin Tërsteniku II (Lagja Gjoka, Bazaj) dhe Poklek i Ri” me numër të prokurimit: 611-13 - 157-521”, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e procesit të prokurimit, për tenderin: “Ndërtimi i kanalizimeve për ujëra të zeza në fshatin Tërsteniku II (Lagja Gjoka, Bazaj) dhe Poklek i Ri” me numër të prokurimit: 611-13-157-521”, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Drenasit në pajtim me Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka konstatuar ndonjë shkelje të dispozitave të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Drenasit më datë 04/11/2013 përmes KRPP-së ka shpallur “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Ndërtimi i kanalizimeve për ujëra të zeza në fshatin Tërsteniku II (Lagja Gjoka, Bazaj) dhe Poklek i Ri” me numër të prokurimit: 611-13-157-521”.

Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurim Publik në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka hasur në ndonjë shkelje që mund të shpie drejt shpërblimit me kontratë në bazë jo meritore.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt!

